



Republika e Kosovës - Република Косово-Republic of Kosovo

Qeveria – Влада – Government

Zyra e Kryeministrit / Канцеларија премијера / Office of The Prime Minister

Zyra e Komisionerit për Gjuhët / Канцеларија повереника за језике

Office of the Language Commissioner

Termet e Referencës

Çmimi për gazetari që promovon përdorimin e gjuhëve 2013

“Pse të promovohet përdorimi i gjuhëve” në Kosovë

1. Historiku

Implementimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve nga komunat e Kosovës mbetet një sfidë që prek rreth 10 për qind të popullsisë së Kosovës, të cilët i përkasin grupeve minoritare kombëtare, etnike, kulturore, linguistike ose religjioze. Për të rritur vetëdijesimin mbi rëndësinë e saj për kontekstin kosovar, Zyra e Komisionerit për Gjuhë, në bashkëpunim me UNDP Kosovë organizon “Çmimi për gazetari që promovon përdorimin e gjuhëve”, që do të mbahet më 17 dhjetor 2013. Kjo ngjarje koincidon me përmbylljen e projektit gjashtë-mujor “Fushata për vetëdijesim publik për të mbështetur implementimin efikas të Ligjit për Përdorim të Gjuhëve duke promovuar të drejtat e njeriut dhe duke kontribuar në përfshirjen e minoriteteve”, me një numër tryezash të rrumbullakëta dhe me video produksione. Si pjesë e kësaj fushate, gazetarët kosovarë të cilët i kanë publikuar gjatë këtij viti raportet e tyre mbi temat që ndërlidhen me përdorimin e gjuhëve në mediat kosovare do të kenë mundësinë të shpërblehen për përpjekjet e tyre dhe për paraqitjen e një rruge të mëtutjeshme, përmes një Çmimi për Gazetari që Promovon Përdorimin e Gjuhëve (JPULP) i cili do të mbahet më 17 dhjetor.

2. Qëllimi

Qëllimi i çmimit për përdorimin e gjuhëve është shpërblimi i cilësisë së shkëlqyer gazetareske në promovimin dhe rritjen e fokusimit kombëtar në përdorimin e gjuhëve si dhe implementimi efektiv i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Po të njëjtën kohë, ai do të inkurajojë edhe publikimet për zgjidhje të reja dhe kreative, që mund të shpijnë në ndryshimin e situatës për të mirë.

3. Kriteret e pranueshmërisë

Juria për rishikimin e storieve përbëhet prej një organi të pavarur i cili do të përfshijë dy (2) gazetarë profesionistë të pavarur, një përfaqësues të shoqërisë civile dhe një përfaqësues nga MDA, si implementues i fushatës për vetëdijesim publik (gjithsej katër). Procesi i përzgjedhjes ka masa të rrepta konfidencialiteti dhe transparence.

Në procesin e përzgjedhjes do të merren në konsiderim kriteret vijuese:

- Ndërlidhja me temën;
- Të jetë adresuar (Pse të promovohet përdorimi i gjuhëve në Kosovë)

- Cilësia gazetareske, përfshirë: objektivitetin, analizë kritike, sensin e rreptësisë dhe atë etik në adresimin e kësaj teme;
- Shumëllojshmëria: përpjekjet për të siguruar që shumëllojshmëria e etniciteteve, zërave dhe ideve pasqyron me saktësi jetën në Kosovë;
- Thellësia dhe vazhdimësia e mbulimit: ndikimi /përcjellja e stories;
- Kreativiteti dhe stili;

Punimet duhet të jenë publikuar brenda periudhës 1 dhjetor 2012 dhe 13 dhjetor 2013.

Punimet mund të jenë në Shqip, Serbisht, Anglisht, Turqisht, Boshnjakisht dhe gjuhën Rome.

Kjo garë është e hapur për qytetarët e Kosovës prej moshës 18 vjeç e lart (më ose para 1 dhjetorit 2012).

Kjo garë ka 5 kategori të rregullta:

Vetëm për gazetarët profesionalë:

- Storia televizive,
- Storia në radio,
- Storia e shkruar në mediat e shtypit
- Storia e shkruar në mediat elektronike
- Fotografia që promovon përdorimin e gjuhëve në Kosovë

4. Juria dhe procesi i përzgjedhjes

Juria për rishikimin e storieve përbëhet prej një organi të pavarur i cili do të përfshijë dy (2) gazetarë profesionistë të pavarur, një përfaqësues të shoqërisë civile dhe një përfaqësues nga MDA, si implementues i fushatës për vetëdijesim publik (gjithsej katër). Procesi i përzgjedhjes ka masa të rrepta konfidencialiteti dhe transparence.

Të gjithë anëtarët e Jurisë do të jenë profesionistë të cilët janë të njohur plotësisht me çështjet e Kosovës.

- Juria do të përzgjedhë, bazuar në kriteret e pranueshmërisë të përmendura më sipër në kategorinë e gazetarëve profesionistë, Artikullin Finalist që i plotëson më së miri këto kritere.
- Fituesi do të shpallet në një ceremoni solemne të shpërblimeve, e cila do të organizohet në Prishtinë, më 17 dhjetor 2013.

Ju lutem, plotësoni aplikacionin në këtë link: <http://www.komisioneri-ks.org/?page=1,95> dhe dorëzoni formularin në emailin vijues: arta.pllana@rks-gov.net.

5. Çmimet

Ky çmim do t'i jepet individit/i cili kontribuon/ka kontribuar shumë dhe dukshëm në promovimin e përdorimit të gjuhëve në Kosovë përmes punës së tij/saj.

Çmimet e gazetarëve profesionistë

Juria do të përzgjedhë storien më të mirë mbi këtë temë si një Storie mediale fituese. Fituesi (shihni komentin e mësipërm) do të shpërblehet me 500 € (Pesëqind euro).

Burimet informative

www.komisioneri-ks.org

www.kosovo.undp.org

www.seemda.com

6. Afati i fundit dhe adresa

Punimet duhet të dërgohen deri më **13 dhjetor 2013 në ora 16:00** në zarfe të mbyllura:

Për: Ndërtesa e Qeverisë, kati i 6^{të}, 605A, Sheshi "Nëna Terezë", 10000 Prishtinë, Kosovë

RE: Çmimi për gazetari që promovon përdorimin e gjuhëve 2013

Për vëmendjen e: Znj. Arta Pllana

Për ndonjë qartësim ose pyetje, ju lutem kontaktoni: arta.pllana@rks-gov.net ose narifi@seemda.com

Asnjë punim që dërgohet pas datës së mbylljes së konkursit nuk do të pranohet. Po ashtu nuk do të merret asnjë përgjegjësi për storiet që humbasin, vonohen, keq-dërgohen ose që janë të papërfunduara ose që nuk mund të dërgohen për arsye të tjera teknike. Dëshmia e dërgimit do të regjistrohet në **Formularin e Regjistrimit**, i cili do të sigurohet nga recepsioni-vendi i pranimit të Zyrës së Komisionerit për Gjuhë. Zyra e Komisionerit për Gjuhë nuk do të jetë përgjegjëse për kthimin e punimeve.

Shënim i rëndësishëm: Paraqitjet duhet të përfshijnë emrin e plotë, adresën e shtëpisë, email-in, numrin e celularit ose/dhe numrin fiks. Aplikantët duhet të theksojnë edhe kategorinë në të cilën konkurrojnë me storien/punimin e tyre.